

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 22 dhjetor 2023

Dr. Vjosa Osmani Sadriu
Presidente e Republikës së Kosovës

E nderuara znj. Presidente,

Referuar diskutimit në takimin e tretë të Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, mes të tjerash është diskutuar rreth çështjes së përfaqësimit gjinor në listat zgjedhore të subjekteve politike.

Avokati i Popullit, duke qenë në pajtim me propozimin tuaj që paraprakisht të tentohet që kjo çështje të rregullohet me amendamentim të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme Ligji për Zgjedhjet), ju njoftoj se kemi analizuar Ligjin për Zgjedhjet dhe kemi vërejtur se dispozitat e nenit 28 [Kuota gjinore] mund të mos jetë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Me këtë rast jua sjellim në vëmendjen tuaj gjetjet e analizës sonë lidhur me Ligjin për Zgjedhjet.

Për sa i përket barazisë para ligjit, sipas nenit 24 të Kushtetutës

Neni 28, paragrafi 1, i Ligjit për Zgjedhjet përcakton: “Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.”

Avokati i Popullit vlerëson se formulimi i nenit 28 në tërësinë e tij, në veçanti në paragrafin 1, nuk dallon nga neni përkatës, neni 27, i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, tanimë i shfuqizuar me Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet. E vetmja risi në këtë nen është e përfshirë në paragrafin 3, i cili përcakton: “KQZ ndanë fonde publike shtesë, në vlerën një për qind (1%) të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik, për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën tridhjetë për qind (30%) në momentin e certifikimit. KQZ-ja planifikon pas çdo palë zgjedhje buxhet shtesë për këtë qëllim.”

Përkitazi me këtë, Avokati i Popullit vlerëson se paragrafi 3 i nenit 28 të Ligjit për Zgjedhjet mund të shihet si masë e veçantë për të arritur barazinë gjinore, mirëpo kuota prej 30%, e përcaktuar për listat e kandidatëve të subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, mbetet

kontestuese për faktin se e cenon barazinë para ligjit dhe në rastin konkret paraqet diskriminim të tërthortë.

Për sa i përket diskriminimit të tërthortë, Avokati i Popullit i referohet praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), në rastin *Dakir kundër Belgjikës*, § 65. GjEDNja rithekson se një politikë ose masë e përgjithshme që ka efekte paragjyquese joproporcionale ndaj një grupi individësh mund të konsiderohet si diskriminuese edhe nëse nuk synon në mënyrë specifike grupin dhe nëse nuk ka qëllim diskriminues. Megjithatë ky është vetëm rasti nëse një politikë ose masë e tillë nuk ka justifikim “objektiv dhe të arsyeshëm”, domethënë nëse nuk ndjek një “qëllim legjitim”, ose nëse nuk ka një “marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti” ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimi që kërkohet të arrihet (shih po ashtu: *S.A.S. kundër Francës*, § 161).

Përcaktimi i kuotës prej 30% për secilën gjini, në dukje nuk paraqet trajtim të pabarabartë mes meshkujve dhe femrave, megjithatë në praktikë nuk ka pasur raste kur subjektet politike i kanë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me 50% femra dhe 50% meshkuj. Vendosja e kriterit prej 30% e përligj trajtimin e pabarabartë, sepse subjektet politike e plotësojnë kriterin ligjor për të garuar në zgjedhje me dërgimin e listës së kandidatëve me 30% femra në listat zgjedhore, ndërsa pjesa tjetër u lihet në vullnetin e tyre, rrjedhimisht në praktikë femrat vazhdimisht mbeten të nënpërfaqësuar.

Vendosja me ligj e kuotës prej 30% për secilën gjini paraqet një lloj paragjykimi të pajustificuar, duke marrë parasysh se përqindja gjinore mes gjinive është pothuajse 50% me 50%, me dallime të vogla. Këtë vlerësim e bazojmë në të dhënat e *World Population Prospects* të vitit 2022, sipas të cilave përqindja në nivelin botëror mes gjinive është 50.3% për meshkuj dhe 49.7% për femra. Ndërsa sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë, në vitin 2011, rezulton me 50.34% meshkuj dhe 49.66% femra. Vërehet se trendi i përqindjes mes meshkujve dhe femrave është pothuajse i barabartë, andaj vendosja e kuotës prej 30%, sikur në ligjin e shfuqizuar, e po ashtu në ligjin e ri, është në kundërshtim me barazinë para ligjit për nga aspekti i barazisë gjinore.

Për sa u përket të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, sipas nenit 45 të Kushtetutës

Lidhur me këtë çështje, sërish i referohemi praktikës së GjEDNJ-së, e cila ka theksuar se të drejtat e garantuara sipas nenit 3 të Protokollit 1 [E Drejta për Zgjedhje të Lira] nuk kufizohen në të drejtën për të kandiduar në zgjedhje ose në vetë zgjedhjet, por mbulojnë periudhën nga fushata zgjedhore deri në ushtrimin aktual të detyrës.

Në këtë drejtim, tërheqim vëmendjen se shumica e listave të subjekteve politike, që kanë garuar në zgjedhjet e përgjithshme të 14 shkurtit 2021, kanë qenë të përfaqësuar me 30% femra dhe me 70% meshkuj, ku edhe atëherë kriter ligjor për kuotën gjinore ka qenë që në listat e subjekteve politike secila gjini të jetë e përfaqësuar me jo më pak se 30%. Në praktikë vërehet se femrat kanë qenë të përfaqësuar me 30%, ndërsa meshkujt me 70%. Ndërsa është vërejtur se pothuajse në të gjitha listat me kandidatët e subjekteve politike, çdo i treti kandidat ka qenë grua, ndërsa dy kandidatët e parë kanë qenë burra.

Në këtë drejtim konstatojmë se një përcaktim i tillë ligjor prej 30% kufizon të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, sepse ua pamundëson femrave të marrin pjesë në listat zgjedhore me pjesëmarrje të barabartë me meshkujt.

Prandaj vlerësojmë se, megjithëse përcaktimi i së drejtës në fjalë bëhet me ligj, në rastin konkret mungon qëllimi legjitim, kufizimi nuk është proporcional dhe se një përcaktim i tillë është në kundërshtim me parimet e një shoqërie të hapur dhe demokratike. Përveç kësaj, një kufizim i tillë mohon esencën e së drejtës së garantuar, e që në rastin konkret është e drejta për t'u zgjedhur dhe e drejta e pjesëmarrjes, si dhe e drejta e barazisë para ligjit.


Për më tepër rikujtojmë se kjo mënyrë e rregullimit ligjor për përfaqësim gjinor në listat zgjedhore të subjekteve politike nuk është në përputhje me rendin kushtetues dhe as me vlerat që janë përcaktuar me nenin nenit 7 të Kushtetues dhe me nenin 24 - Barazia para Ligjit.

Prandaj, bazuar në gjithë këtë që u theksua më sipër, do ta mirëpresim nismën për amendamentimin dhe ndryshimin e nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në frymën e analizës së paraqitur më sipër, në mënyrë që femrave dhe meshkujve t'u garantohet qasje e barabartë faktike për kandidaturë në listat zgjedhore të subjekteve politike, gjithmonë duke pasur në konsideratë afatet ligjore, pasi më 18 janar 2024 përfundon afati 6 mujor i përcaktuar për Avokatin e Popullit për ngritjen e çështjes së kushtetutshmërisë të ligjeve të miratuara nga Kuvendi, sipas Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit



Për dijëni:

- Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti